



## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës në çështjen penale ndaj të akuzuarit U. Th. nga fshati . Komuna e R., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë në bashkëkryerje, nga neni 315, paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 31, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkritazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit së të akuzuarit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil 2023:130871 të datës 28.04.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti i Përgjithshëm, PN1.DP.nr. 622/2024 të datës 13.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.06.2024, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të akuzuarit U. Th., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil 2023:130871 të datës 28.04.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti i Përgjithshëm, PN1.DP.nr. 622/2024 të datës 13.05.2024.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil 2023:130871 të datës 28.04.2024, të akuzuarit U. Th., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë në bashkëkryerje, nga neni 315, paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 31, të KPRK-së, i ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, ashtu që sipas këtij aktvendimi, paraburgimi të akuzuarit i është llogaritur nga data 30.04.2024 e deri me datën 29.06.2024. Të akuzuarit paraburgimi i është vazhduar konform dispozitës së nenit 190 lidhur me nenin 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 e 1.2 pikat: 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PN1. DP. nr. 622/2024 të datës 13.05.2024, e ka refuzuar si të pabazuar

ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit U. Th. etj., dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit U. Th., avokat A. K. nga Gj., për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 pika 2.1 e KPP-së; nenit 432 pikat: 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPP-së; nenit 445 paragrafi 1 pikat: 1.1, 1.2 lidhur me nenin 184 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2 pikat: 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së, shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovojë si të bazuar kërkesën, të ndryshoj aktvendimet e atakuara me kërkesë, ashtu që të akuzuarit t'i ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjti të lirohet për t'u mbrojtur në liri ose t'ia mundësoi mbrojtjen në liri nën masën e arrestit shtëpiak.

Zyra e Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.153/24 e datës 10.06.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës e në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, mbrojtësi i të akuzuarit thekson se me aktvendimet e atakuara me kërkesë, nuk janë dhënë arsye konkrete dhe të pranueshme lidhur me bazat juridike për vazhdimin e masës së paraburgimit, vetëm se kanë parafrazuar theksimet si në arsyetimin e kërkesës së prokurorit për vazhdimin e paraburgimit, të cilat arsye s'pari nuk janë të qarta, të besueshme dhe nuk elaborojnë rrethanat mbi bazën e të cilave thirren dispozitat në fjalë për vazhdimin e masës së paraburgimit.

Sa i përket vazhdimin të paraburgimit nga baza ligjore e rrezikut të ikjes-arratisjes, nëse i akuzuari ndodhet duke u mbrojtur në liri, vetëm për arsye se për këtë vepër penale parashihet dënim i lartë nëse i njëjti shpallet fajtor, sipas mbrojtjes nuk qëndron për faktin se gjykatat, si në rastin konkret nuk sqarojnë se cili është rreziku konkret, se cilat rrethana janë konkrete, që e krijojnë bindjen te gjykata se i akuzuari mund të ik, andaj arsyetimi sipas kësaj baze ligjore është abstrakt dhe i pa bazuar me asnjë provë, për faktin se i akuzuari ka identitet publik, është shtetas i Republikës së Kosovës, nuk ka shtetësi tjetër, i njëjti ka vendbanim të përhershëm në fshatin Kramovik Komuna e Rahovecit, nuk ka vendbanim tjetër, është mbajtës i familjes së tij bashkëshortes me (3) fëmijët dhe prindërve të moshuar e të sëmur.

Tutje theksohet në kërkesë nga mbrojtësi i të akuzuarit se nuk qëndron kushti i vazhdimin të paraburgimit as nga baza ligjore e ndikimit e të akuzuarit, në dëshmitar apo bashkëpandehur, nga se dëshmitarët e propozuar nga prokuroria për seancë gjyqësore, por edhe dëshmitar tjerë eventual, ky konstatim nuk ka bazë ligjore dhe faktike, sepse nuk ka asnjë provë të prezantuar se i akuzuari mund të ndikoj në dëshmitar, por se vetëm

konstatohet në mënyrë hipotetike (imagjinare), për faktin se gjithë këta dëshmitar kanë dhënë dëshminë në polici dhe prokurori dhe se as që mund të pengojnë rrjedhën e procedurës penale.

Po ashtu, mbrojtja thekson në kërkesë se i mbrojturi i tij nuk paraqet as rrezik të përsëritjes së veprës penale, nëse i njëjti ndodhet duke u mbrojtur në liri, për shkak të peshës së veprës penale dhe rrethanave në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale, sepse kjo bazë ligjore, pos peshës së veprës penale duhet të përmbushen komulativisht edhe kushtet tjera të cilat tregojnë ekzistimin e rrezikut real për përsëritjen e veprës penale nga ana e të akuzuarit siç janë rrethanat personale të kryesit, ambienti në të cilin jeton dhe rrethanat tjera personale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme në kërkesë janë të pabazuara, ngase si gjykata e shkallës së parë po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë dhënë arsye të mjaftueshme për bazat ligjore të vazhdimit të paraburgimit. Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, rezulton dyshimi i bazuar se i akuzuari është kryerës i veprës penale për të cilën edhe është ngritur aktakuzë, me çka është plotësuar kushti ligjore nga neni 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 të KPP, për vazhdimin e paraburgimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se ende ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit nga neni 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.1 të KPP-së, ndaj të akuzuarit, sepse nëse i njëjti ndodhet duke u mbrojtur në liri, lehtë mund të ik- arratiset, me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, duke marrë për bazë peshën e veprës penale për të cilën dyshohet se e ka kryer, përkatësisht veprën penale të vjedhjes së rëndë në bashkëkryerje, ku sipas kualifikimit ligjor të kësaj vepre penale, nëse shpallet fajtor, të njëjtit i kanoset dënim i lartë, përkatësisht dënim me burgim deri në 10 vite, prandaj kjo shton dyshimin e bazuar se i njëjti mund të ik, e të jetë i pa arritshëm për organet e ndjekjes, me çka do të pamundësohej zhvillimin e rregullt në këtë çështje penale, andaj sipas vlerësimit të gjykatës është i domosdoshëm vazhdimi i paraburgimit në këtë fazë të procedurës me qëllim të sigurimit të prezencës së të akuzuarit në procedurë.

Po ashtu, qëndron baza ligjore nga neni 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.2 të KPP-së, për vazhdimin e paraburgimit ndaj të akuzuarit Urim Thaçi, ngase ka arsye për të besuar se po të gjendet i akuzuari në liri, i njëjti do të pengoj rrjedhën e procedurës penale pasi që ekziston rreziku se i njëjti mund të ndikoj në dëshmitarët të cilët janë propozuar me aktakuzë, që të dëgjohen gjatë shqyrtimit gjyqësor, e këtë duke pasur parasysh se me aktakuzë janë propozuar për t'u dëgjuar 14 dëshmitar si dhe ekziston rreziku se i akuzuari lehtë mund të ndikojnë tek të tjerët për të dhënë dëshmi në favor të tyre, për faktin se të njëjtit akuzohen se veprën penale vjedhje e rëndë dyshohet se e kanë kryer në bashkëkryerje, andaj vazhdimi i paraburgimit në këtë fazë të procedurës është i nevojshëm.

Gjithashtu qëndron baza ligjore nga neni 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.3 të KPP-së për vazhdimin edhe më tutje të paraburgimit ndaj të akuzuarit në fjalë, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat dyshohet se ka kryer veprën penale në bashkëkryerje pasi që i akuzuarit, në bashkëveprim me të

akuzuarit tjerë dyshohet se kanë vjedhur shumat në lartësi prej: 114.000,00 euro, 60.000,00 franga zvicerane , 1.000,00 funta angleze, si dhe nga kasaforta kanë marrë 400,00 franga zvicerane, 13.000,00 lek shqiptar, si dhe një çantë në të cilën kishte pasur stoli ari në vlerë prej 1.600,00 euro, mjete të cilat janë mbledhur me vite të tëra nga besimtarët –Myhpet dhe kanë qenë të destinuara për qëllime fetare, përkatësisht për ndërtimin e një objekti kulti fetar (tege), andaj vazhdimi i paraburgimit, ndaj të akuzuarit në këtë fazë të procedurës është i bazuar në ligj, i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për zhvillimin e pa penguar, të suksesshëm dhe efektiv të rrjedhës së procedurës penale dhe sigurimit të akuzuarit në procedurë.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, si dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta dhe ligjore i vlerëson edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera alternative nga neni 171 i KPP-së, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.3363/2024, më datë 12.06.2024

Bashkëpunëtori profesional,  
Sherif Krasniqi

Kryetare e kolegjit,  
Mejreme Memaj